



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____._____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje transformatori dhe pajisje mbrojtje për gabinën elektrike godina e Bashkisë si edhe materiale elektrike për ndriçimin e rrugëve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 31681410-0
Materiale elektrike, (CPV): 31174000-6 Transformatorë furnizimi me energji elektrike.

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 666 667 (pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh, nga e cila:

- 3 166 667 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh nga Granti, nga e cila:

Për vitin 2023: 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë pa Tvsh.

Për vitin 2024: 1 666 667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh.

- 2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat për vitin 2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Divjakë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2019, 2020 dhe 2021 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM Nr.285/2021 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bere që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe

pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma c, të Nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe percaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme: Certifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë. Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit,*, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se Certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i

pajisur dhe të paraqesë certifikaten e standartit si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, te lidhura ngushte me objektin e prokurimit dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i ISO-s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë te lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojne konkurrencën, OE duhet ta paraqesin ate.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zërat e mallrave të kërkuar, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuar zërat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre (*të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar*). Në katalog/katalogje duhet të markohet produkti që ofrohet.

[Pjesët e katalogut/katalogjeve ku tregohen produktet e ofertuara duhet të jetë i përkthyer në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kërkuara si dhe i noterizuar].

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike.* Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-së dhe rekomandimeve të APP-së, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar që të paraqitet katalogje për disa mallra objekt prokurimi sipas tabelës për shkak të peshës specifike që zenë në preventivin e mallrave. Paraqitja e katalogjeve për disa zëra mallrash, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të cilës të deklarojë se, merr përsipër të kryejë furnizimin dhe shërbimin e transportit të mallit të kërkuar pranë Bashkisë Divjakë, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane te deklaratave, per te garanuar permbushjen me sukses te kontrates nga OE dhe dhenia e sigurise AK-se qe kontrata do te realizohet sipas kerkesave te percaktuara ne DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë me anë të një deklarate, se mallrat e kërkuar sipas preventivit, duhet të kenë garanci jo më pak se 12 muaj, duke filluar nga momenti i furnizimit.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Materialet e nevojshme elektrike të projektit si transformatori dhe paisje mbrojtëse për gabinën elektrike të godinës së Bashkisë Divjakë si edhe materiale të tjera elektrike që do të shërbejnë për ndriçimin e rrugëve duhet t’i përmbahen specifikimeve të mëposhtme:

Cele transformatori TM 20 KV me gas sf6 (e re)

Pershkrimi:

- Cele Transformatori me izolacion 24 kV.
- Duhet te kete markimim CE , gjithashtu te plotesoje standartet IEC,SEISMIC,UTE.
- Cela duhet te jete e pajisur me suguresa Tubolare 24 kV per mbrojtjen e transformatorit.
- Cela duhet te jete e pajisur me mekanizmin ndaresit te thikes se Linjes.
- Cela duhet te jete e pajisur me mekanizmin e ndaresit te thikes se Tokes.
- Cela duhet te jete e pajisur me treguesit sinjalizive per veprimet e komutimit te permendura ne piken e 4 & 5.
- Cela duhet te jete e pajisur me GAZ te llojit SF6 per shuarjen e harkut elektrik gjate komutimeve.
- Cela duhet te kete indeksin e mbrojtjes IP3X.
- Cela duhet te jete e afte per te perballuar nje kapacitet ngarkese deri ne 630 A ne tension 20 kV.
- Cela duhet te kete aftesi C-kycese ne ngarkese (12.5 kA per 1 sec).

- Cela duhet te operoje ne nje temperature nga -40 deri me 70 grade Celsius.
- Cela duhet te punoje ne nje frekuece 50 Hz.
- Cela duhet te jete e vitit te prodhimit 2022-2023.

Kabllo ajror ABC me Vetembajtje ne te gjithë kabllin (Kablllo ABC)

Kabllo e TU me percjellesa alumini me vetembajtje perdoren ne rrjetin e energjise elektrike TU per linjat ajrore, per lidhjen e shtepive etj dhe per instalime ne nivelin e tensionit 0.6/1 kV. Vecanerisht ato jane te pershtatshme per tu vendosur ne hapësira te limituara ose ne kryqezime. Tensioni i punes mund ta tejkaloje tensionin nominal deri ne 20 %. Keta kablllo jane me izolacion XLPE.

1-Te pergjithshme:

Kabllli XLPE me vetembajtje do te perdoret per linjat e tensionit te ulet.

Do te funizohen kablllo me vetembajtje ne te gjithë kabllin.

Kater percjellesit e aluminit perbehen nga tre fazat dhe percjellesi i neutrit. Seksionet e kabllit jane si me poshte:

- XLPE 4 x 16 mm² 0.6/1 kV Al,

2-Kushtet e sistemit

Te dhenat e sistemit	Njesia	
Tensioni me i larte ne sistem	kV	0.66
Tensioni nominal	V	230/400
Frekuenca	Hz	50
Numri i fazeve	No	3 faze/4 percjellesa
Sistemi i tokezimit		Direkt ne toke

3-Kushtet atmosferike

Temperatura maksimale e ambientit	40°C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Lageshtia maksimale relative	80%
Lartesia maksimale nga niveli i detit	1000m

4-Pershkrim, Kerkesa dhe te Dhena

Kabllli me katër percjelles përbëhet nga përcjellësa alumini të izoluar të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe nuk kanë mbulesë të përbashkët. Çdo përcjellës përbëhet nga tela alumini të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe janë të gjithë të izoluar me një mbulesë polietileni; kjo mbulesë përforcohet dhe testohet me një izolim të dyfishtë.

Të gjithë këta përcjellës funksionojnë si një i vetëm, duke e shperndare sforcimin në të gjithë gjatësinë e tyre .Percjellesit jane rezistent ndaj ujit dhe rrezatimit ultraviolet.

Seksioni	Diametri jashtem	Rezistenca aktive	Rryme e lejuar	Qendrushmeria	Pesha
4x16 mm ²	19mm	1,91 Ohm/km	81 A	2,8 KN	303kg/km

Terminale TM 10 KV

Seksioni percjellesit deri 70 mm².

Tipi terminalit punim me ngrohje.

Te kete markimin CE.

Te jete ne perputhje me standartin SSH/ CENELEC HD629.1 S2.

Kabell bakri 2x1,5 mm²

Kabelli te jete me percjelles bakri i tipit H05VV-F ose FROR.

Kablli te plotesoje standartin VDE 0281.

Percjellesi i bakrit te jete fleksibel me izolim PVC te percjellesit dhe izolim PVC te jashtem.

Temperatura e punes se kabllit 70 grade Celsius.

Temperatura e lidhjes se shkurter 160 grade Celsius.

Tensioni i punes 300/500V.

Tensioni i proves (AC) 2 KV.

Krahe ndricuesi me fasheta

Krahu i ndricuesit sherben per fiksimin e ndricuesit ne shtylle.

Diametri i tubit te celikut duhet te jete 60 mm dhe tubi duhet te jete Krahe Ndricuesi i galvanizuar.

Gjtesia e krahut te jete 1,2-1,5 meter.

Tubi gjithashtu duhet te jete i pajisur me dy fasheta per tu fiksuar ne shtylle.

Krahu duhet te jete i pajisur me bulonat qe sherbejne per fiksimin e tij.

Krahu duhet te kete forme te harkosur ne menyre estetike.

Fotoelement

Fotoelementi sherben per kycjen dhe ckycjen e ndricimit rrugor ne varesi nga drita.

Kjo rele punon me tension 230V 50 Hz.

Shkalla e mbrojtjes eshte IP 65 dhe regjistrimi i ndricimit 2-200 lux.

Kontakti i fotoelementit eshte deri 16 A.

Materiali i fotoelementit duhet te rezistoje rrezet UV.

Kontaktoret (Leshuesat)

Kontaktoret duhet te plotesojne standartin SSH/EN 60947 -1.

Kontaktoret duhet te kene markimin CE.

Numri i kycje ckycjeve elektrike duhet te jete me I madh se 10000000.


Numri i kycje ckycjeve mekanike duhet te jete me I madh se 10000000.

Pjesa plastike e kontaktorit duhet te jete rezistente ndaj UV dhe halogjen free pra veteshuarese te mos stimuloje zjarrin.

Aksesorët për linjat TU me kablo ajrore

a. Nyje lidhese e izoluar per linjen kryesore(bashkuese)

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Karakteristika


Nyja lidhese e izoluar per linjen kryesore(bashkuese) eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te magjstralit dhe te degezimeve te linjes me percjelles alumini me vetembajtje me te njejtin seksion, pa e hequr izolimin e percjellsave. Ne kete menyre nuk lihen ne percjellsat kryesore dhe ata te abonentit, pjese percjellese te zhveshura. Kontaktet e tyre duhet te jene projektuar prej materiali qe te lejoje

lidhjen elektrike ne percjellsa prej alumini dhe bakri. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues. Gjate shtrengimit te bulonit "dhembet" duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave. Rezistenca e kontaktit qe realizohet duhet te jete ne temperaturen 20 oc jo me i madh se 265 mikro Ohm, por jo me e madhe se 0.815 e vleres se rezistences se percjellesit me seksion me te vogel qe mer pjese ne lidhje. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrueshmerine mekanike te percjellsave. Pjeset plastike izoluese duhet te jene prej polimeresh te perforcuara me fibra xhami dhe rezistente ndaj rezatimit ultraviolet.

Parametrat teknike

Seksioni i percjellesit kryesor (min-maks)	Seksioni i degezimit (min-maks)
[mm ²]	[mm ²]
16-95	16-95
25-120	25-120

b. Nyje lidhese te izoluar(konektore) rakorduese dhe abonenti
(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Karakteristikat

Nyja lidhese e izoluar rakorduese eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te percjellsave te linjes me percjelles alumini me vetembajtje me degezimet qe nuk kane te njejtin seksion si dhe me kabllin e abonentit, pa e hequr izolimin e percjellsave. Ne kete menyre nuk lihen ne percjellsat kryesore dhe ata te abonentit, pjese percjellese te zhveshura. Kontaktet e tyre duhet te jene projektuar prej materiali qe te lejoje lidhjen elektrike ne percjellsa prej alumini dhe bakri.

Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues. Gjate shtrengimit te bulonit "dhembet" duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave. Rezistenca e kontaktit qe realizohet duhet te jete ne temperaturen 200C jo me i madh se 265 mikro Ohm, porjo me e madhe se 0.815 e vleres se rezistences se percjellesit me seksion me te vogel qe mer pjese ne lidhje. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrueshmerine mekanike te percjellsave. Pjeset plastike izoluese duhet te jene prej polimeresh te perforcuara me fibra xhami dhe rezistente ndaj rezatimit ultraviolet.

Parametra Teknike

Seksioni i percjellesit kryesor (min-maks)	Seksioni i degezimit (min-maks)
[mm ²]	[mm ²]
16-95	4-35(50)

Paneli metalik i komandimit

Paneli duhet te jete me permasa 300x250x155.

Paneli duhet te jete i pajisur me bazen prej ilamarine per fiksimin e elementeve.

Shkalla e mbrojtjes te jete IP65 ose IP66.

Paneli duhet te jete i pajisur me celes te kete markimin CE.

Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike te jete IKIO sipas standartit IEC60529.

Paneli te jete i lyer me boje RAL 7035 me pjekje.

Trashesia e llamarines te jete 1,4-1,5 mm.

Paneli i komandimit duhet te jete i pajisur me sensorin e muzgut 16 A me shkalle komandimi.

Sipas shkalles se ndricimit , kontaktore , automat , shkarkues TU , klema dhe shine per fiksimin e tyre , klemate panelit dhe rekorderite e kabllave hyrese dhe dalese.

Paneli duhet te jete i pajisur me fashetat e fiksimin ne shtylle.



Transformator fuqie

Fuqia nominale	250 KVA
Tipi i transformatorit	me vaj
Tensioni primar	10 KV
Tensioni sekondar	04 KV
Numri i fazave	3 (tre)
Frekuenca	50 Hz
Grupi i lidhjes	Dynll
Metoda e ftohje	ONAN
Te kete markimin	CE

Ndricues rrugor Led 100 W

Materiali i trupit te ndricuesit te jete alumini

Burimi i ndricimit Led Module

Material optic PMMA

Materiali difuzorit xham

Fuqia e Led 100 ë

Eficienta e Led 136lm/ë

CRI > 70

Te kete shkarkues tensioni SP IOKV

Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike IK08

Shkalla e mbrojtjes nga pluhuri dhe lageshtira IP66

Pjesa optike lente matrix

Te kete markimin CE

Menyra e montimit ne shtylle me dy menyra me krahe dhe direkt ne shtylle ne maje set saj

Te kete rregullim kendit te ndricimit +15 grade deri -15 grade .

Ngjyra e ndricimit 4000K Ose 6000K



Kabull TM 10 KV 3x70mm²

Tensioni nominal i punes 10 KV
Percjellesi i aluminit class 2
Tipi NA2XSEYBY 6/10 KV
Temperatura maksimale e punes 90 grade
Temperatura Maksimalee Ish 250 grade
Veshja e jashtme Polivinil Chloride
3x70/16
Te kete markimin CE

Ndricues rrugor Led 100 W ne forme koni

Diametri i fiksimit ne shtylle d: 60mm
Lartesia e ndricuesit rreth 620 mm
Diametri maksimal rreth 650 mm
Materiali i ndricuesit Policarbonat rezistent kundrejt UV
Difuzori polikarbonat transparent rezistent ndaj UV
Shkalla e mbrojtjes nga pluhuri dhe lageshtira IP 66
Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike IK 10
Tensioni i punes 230V/50Hz
Fuqija e ndricuesit deri 100 ë LED E 27
Standarti qe ploteson ndricuesi SSH/EN60598 , SSH/EN 60068-2-29



Shtylla betoni H8

Kerkesa teknike te detajuara (pjerresia e shtylles 1.5%)

Shtylla 8.0 m (vetem mbeshtetese ne rastin e riparimeve)
Dimensionet e diametrave jane te rekomanduar

Kriteret e ndertimit	Njesia	Gjatesia/Forca (m/kN) Shtylla 8/6
Gjatesia	m	8
Diametri d1	mm	130
Diametri d2	mm	250
Vlera e forces nominale operuese	kN	6

Ilustrimi



Tirantues ankeror i thjeshte (Tirantues abonenti)

Karakteristika


Aksesori "Tirantues ankeror i thjeshte" për linjat me kablllo alumini me vetembajtje shërben për të fiksuar kabllin e abonentit. Ato janë projektuar për të fiksuar kablllo njëfazor dhe trefazor.

Tirantuesi ankeror i thjeshte fikson të gjithë kabllin.

Trupi metalik i tirantuesit ankeror, si në rastin kur është në formë pjastre ashtu edhe në formë rethore, realizohet prej çeliku të galvanizuar. Fiksimi dhe shtrengimi i përcjellsave të linjes realizohet nëpërmjet një sistemi paketash polimere të forcuara me fibra xhami, rezistent ndaj rezatimit ultraviolet, të tipit veteshtrëngues ku kablli zë vend (fle) në folene të vetë. Sistemi i pllakave prej polimeresh fiksohet në trupin metalik të tirantit ankeror me anën e prizhionierave fiksuara. Për të shmangur sforcimet e pa nevojshme, tirantuesit janë me krah të levizshëm dhe të rotullueshëm në përputhje me drejtimin e orientimit të vetë linjes duke krijuar një çift rotullues.

a. Tipi me krah hark çeliku unik

(Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese)




Parametrat teknike

[mm]	[kN]
Ø3.5-5.5	3
Ø 5.6-7.5	3

Ø 9-17	3
Ø 6-21	3
Ø 18-25	3

b. Iloji me krah hark celiku fleksibel
(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)




Qafore per shtylla betoni

a. Aksesori Shtyllor (Qafore) per terheqje ne dy krahe

Keta projektohen per t'u fiksuar ne to "tirantuesit ankerore te linjes" dhe per te trasmetuar ne shtyllle sforcimet mekanike te linjes me percjelles alumini me vetembajtje. Materiali çelik SSH/EN 10025, 50x6 mm I galvanizuar në të nxehtë trashesia e galvanizimit jo me e vogel se 60 µm. Te gjitha buzet do te jene me zmuso (te rumbullakosura). Qendrueshmeria mekanike e tyre per secilin nga "nyjet" e tij ku fiksohet "tirantuesi ankerues", duhet te jete jo me pak se 45 kN. Gama e propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



ØD	Ød	e
[mm]	[mm]	[mm]
61	18	12
77	18	12
120	18	20
130	18	20
140	18	20
160	18	20
180	22	20
190	22	20
220	22	20
240	22	20
260	22	20

b. Aksesori shtyllor (Qafore) aboneti dhe qafore linje dhe abonenti

Celik SSH/EN 10025, galvanizim ne te nxehtë, od = 12-14 mm.

Qendrueshmeria mekanike e tyre per secilin nga "nyjet" e tij ku fiksohet "tirantuesi ankerues", duhet te jete jo me pak se 45 kN.

Gama e propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.



Qafore abonenti

Qafore linje dhe abonenti

Tipi 1:

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)

<u>Dmin-Dmaks</u>
[mm]
140-170
170-210
200-240
240-280


d=12 mm celik i rumbullakte i galvanizuar ne te nxehte

Tipi 2:

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)

Qafore abonenti

Qafore linje dhe abonenti



Kabell Alumini 4X240 Mm2

- Seksioni percjellesit te je te 240 mm2.
- Percjellesi te jete alumin class 2.
- Percjellesi I izoluar me XLPE.
- Veshja e jashteme te jete halogen free (HFFR).
- Te kete markimin CE.

Tub Korrugato 160 mm

- Diametri i brendshem i tubit te jete 160 mm.
- Tubi te jete fleksibel me dopjo veshje.
- Te kete markimin CE.

Traversa per vendosjen e shkarkuesave

Traversa te jete me vrima me diameter 10 mm per fiksime .

Te kete vrima te montimin e shkarjuasave dhe te jete e zinkuar per ti rezistuar korrozionit.

Buloneri per montime elektrike

Bulona dado dhe rondele te permasave te ndryshme.
Te jene te zinguara per ti rezistuar korrozionit.

Kabull bakrri 2X6 mm²

Kablli te jete me percjelles bakri i tipit H05VV-F ose FROR.
Kablli te plotesoje standartin VDE 0281.
Percjellesi i bakrit te jete fleksibel me izolim PVC te percjellesit dhe izolim PVC te jashtem.
Temperatura e punes se kabllit deri 70 grade Celsius.
Temperatura e lidhjes se shkurter 160 grade Celsius.
Tensioni i punes 300/500v.
Tensioni i proves (AC) 2 KV.
Te kete markimin CE.

Shirit tokezimi 40x4mm

Shiriti te jete me permasa 40x4 mm i zinguar.
Te kete markimin CE.
Gjatesia sipas paketimit.

Kapikorta bakri 35 mm²

Kapikortat te jene me seksion 35 mm² dhe vrime 8 ose 10 mm diameter.
Te kene markimin CE te jene te zinguara.

Kapikorta AL-CU 240 mm²

Kapikortat te jene ne pjesen e futjes se kabllit Alumini dhe pjesa e vrimes bakri.
Pjesa se aluminit te jene 240 mm² .
Vrima e kapjes me bullon te jene sipas standartit.
Te kete markimin CE.

Shkarkues TM 10 KV

Shkarkuesat te jene porcelani ose polimeri.
Tensioni maksimal i punes te jene 12 KV
Te kene markimin CE.

** Shënim: Në respektim të nenit 36 të LPP-së, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

** Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushes, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT